

**VENDIMI**  
**Nr. 486, datë 21.7.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PAVLEFSHMËRINË E KONTRATAVE TË PROKURIMIT PUBLIK<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 119, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi kompetent për shqyrtimin e ankesave për pavlefshmërinë e kontratave.

2. Me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vendos pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të kontratës, me anë të një vendimi të ndërmjetëm, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Komisioni i Prokurimit Publik mund të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë zbatimin e kontratës, nëse pezullimi mund të çenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.

3. Komisioni i Prokurimit Publik mund të shpallë një kontratë absolutisht të pavlefshme, kur konstaton ekzistencën e kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 119 të LPP-së.

4. Nëse pas shqyrtimit të të gjithë aspekteve përkatëse, çmohet se shpallja e pavlefshmërisë absolute të kontratës mund të çenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mos e shpallë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontratën në fjalë, si:

- a) kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës;
- b) kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi;
- c) kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik, që do të zbatojë kontratën;
- ç) kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë.

5. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, në rastin kur nuk shpallet pavlefshmëria e kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos:

- a) të shkurtojë afatin e zbatimit të kontratës;
- b) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor, për shkeljet e konstatuara, sipas këtij vendimi.

6. Gjoha duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast, jo më shumë se 10% e kësaj vlere.

7. Në vendosjen e masës së gjobës, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të marrë në konsideratë disa elemente, si:

- a) rrethanat, në të cilat është kryer shkelja;

---

<sup>1</sup> Ky vendim përafrohet pjesërisht me:

- Direktivën 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike, me numër CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 395, datë 30.12.1989, faqe 33–35.

- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, me CELEX 31992L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 76, datë 23.3.1992, faqe 14–20.

- b) rëndësia e shkëljes së kryer;
- c) pasojat, që kanë ardhur;
- ç) proporcionaliteti midis dëmit të shkaktuar dhe masës së gjobës;
- d) vlerën e përlogaritur të kontratës;
- dh) parimet e prokurimit, që janë shkelur;
- e) përsëritjen e shkeljeve në raste të tjera.

8. Komisioni i Prokurimit Publik përcakton në vendimin e tij afatin brenda të cilit duhet zbatuar vendimi i dhënë.

9. Palët kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas përcaktimit në nenin 121 të LPP-së.

10. Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**